



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____.2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

“Mbi dhënien e ndihmës ekonomike me 6% të fondit të kushtëzuar të bllok ndihmës ekonomike muaji GUSHT 2024”.

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ' Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë', bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin në.9355 datë 10.03.2005 " Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike", si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale,
3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune,
4. Familje me shumë fëmijë
5. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin;
6. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë anëtarë me paaftësi/invalidë pune

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike për muajin **GUSHT**, **41** familje me fond **226.046 LEKË**.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.

Përgjegjës i Shërbimit Social

Besim HANA

Kryetari i Bashkisë

Nuri BELBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr.....prot.

Prrenjas, më/...../2024

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ Datë _____

“Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga Fondi Social”

Duke u mbështetur në Ligjin nr 57, datë 18.07.2019 ‘Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë’, bazuar gjithashtu në Ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” i azhornuar me ligjin nr.10399 datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar në nenin 7, në VKM nr.787 datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, si dhe udhëzimeve në zbatim të tyre, administratorja e zyrës së ndihmës ekonomike i propozon Këshillit të Bashkisë, të trajtohen me ndihmë ekonomike me kriter të veçantë:

1. Familje të varfëra të cilat janë refuzuar për shkaqe administrative nga sistemi i pikëzimit,
2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe administrative dhe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019“Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar(apo në burg)dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat perkatës.
4. Familje me probleme të tjera sociale.

I propozoj Këshillit të Bashkisë të trajtohen nga Fondi Social i ndihmës ekonomike për muajin **GUSHT**, 4 familje me fond 26.000 LEKË.

Bashkëngjitur është lista e familjeve.

Përgjegjës i Shërbimit Social

Besim HANA

Kryetari i Bashkisë

Nuri BELBA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT**

Nr ____ Prot

Prrenjas, më ____ / ____ / 2024.

PROJEKT – VENDIM
NR ____ DATË ____ / ____ / 2024

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË RISHIKUAR TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027 PËR BASHKINË PRRENJAS


Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” neni 54, pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetqeverisjes Vendore”, neni 36,të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë “ , i ndryshuar, në Udhëzimin Nr.9 Datë 20.03.2018 .“Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit“, udhëzimin nr 3 Datë 28.02.2024“Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, udhëzimin plotësues nr 8 Datë 05.07.2024“Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, referuar Relacionit të Përgatitjes së Programit të rishikuar Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak:

- Të miratojë “Parashikimin e burimeve të të ardhurave të Bashkisë Prrenjas për vitet buxhetore 2025-2027”.
- Të miratojë “Planifikimin e taveve afatmesme të shpenzimeve për Bashkinë Prrenjas” sipas Formateve.
- Të miratojë “Investimet afatmesme në nivel programi të Bashkisë Prrenjas” sipas Formateve.
- Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit , Drejtoria e B.Njerezore dhe Sektori Juridik, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit si edhe Institucionet në varësi të Bashkisë Prrenjas.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe pas shprehjes së ligjshmërisë së Prefektit të Qarkut Elbasan.

Bashkangjitur Relacioni i Përgatitjes së Programit të rishikuar Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027.

Konceptoi: Sp. i Financës dhe Buxhetit L. Toska
Përgj. i Financës dhe Buxhetit A. Blloshmi
Pranoi: Dr. i Financës dhe Buxhetit S. Kapxhiu

**KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr ___ Prot

Prrenjas, më ___ / ___ / 2024.

PROJEKT – VENDIM
NR ___ DATË ___ / ___ / 2024

“Per
Miratimin e Raportit te Monitorimit te Buxhetit per Periudhen Janar- Gusht 2024”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 pika “dh”, të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Udhëzimin Nr.2 Date: 06.02.2012 Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe VKM 608 Nr 27.10.2025 “Per Buxhetin e vitit 2024;Vkb nr 6 date 27.12.2023”Per miratimin perfundimtar te PBA 2024-2026 dhe Buxheti 2024”;Keshilli i Bashkisë i mbledhur sot me datë ___ / ___ / 2024 me propozim të Kryetarit te Bashkisë Prrenjas ;

V E N D O S I:

- 1.Te miratoje raportin e monitorimit te buxhetit per periudhen Janar- Gusht 2024” sipas formateve,bashkelidhur dhe relacioni shpjegues.
2. Per zbatimin e ketij projekt vendimi ngarkohet Drejtoria.e Finances dhe Buxhetit dhe Drejtoria e te Ardhurave

KRYETARI I BASHKISË

Nuri BELBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr ____ Prot

Prrenjas më: ____. ____. 2024

P/VENDIM
NR ____ DATË ____. ____. 2024

“PËR MIRATIMIN E FONDIT TË RRIJTJES SË NIVELEVE TË PAGAVE SIPAS KUFIRIT MINIMAL PËR FUNKSIONET E ZGJEDHURA E TË EMËRUAR, TË NËNPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE SIPAS SHKRESËS NR.11788 PROT DATË 04.09.2024 ”

Në zbatimin të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, VKM NR.503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin Nr.328, datë 31.05.2023, të këshillit të ministrave për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” si dhe shkresës dërguar nga Ministria e Financave me nr 11788 prot datë 04.09.2024, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____ / ____ / 2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas

VENDOSI:

1. Të miratoj shtesën e fondit për rritjen e niveleve të pagave sipas kufirit minimal sipas tabelës së mëposhtme

E Q	M L	KOD INST	EMERTIMI	KAP	PROGRAMI	LLOGARIA EKONOMIKE	KOD DEGA E THESARIT	SHUMA
			SHTOHET					
153	00	2153001	PAGA+ SHTESA	01	01110	600	0821	6,995,262
153	00	2153001	SIGURIME SHOQERORE, SHENDETESORE	01	01110	601	0821	1,402,412
			Totali					8,397,674

2. Ngarkohen për zbatim e vendimit : Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Nr ____ Prot

Prrenjas më: ____ . ____ . 2024

P /VENDIM

NR ____ DATË ____ . ____ . 2024

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.05 DATË 27.12.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE TË PUNONJËSVE E TË PERSONAVE
TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR PËR VITIN 2024

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54 pika ç, Ligji nr 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave ,trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e Administratës Publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", VKM nr.503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.328,datë 31.05.2023,të këshillit të ministrave për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____ . ____ . 2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Prrenjas

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke filluar nga data 01.09.2024
2. Shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë Prrenjas.
3. Shpërblimin e kryetarëve të fshatrave në masën 10% të pagës së Administratorit të Njësive Administrative përkatëse.
4. Miratimi i nivelit të pagave sipas tabelës bashkëngjitur.
5. Ngarkohen për zbatim e vendimit: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

KRYETARI I BASHKISË
NURI BELBA